Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0904

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) ENG IDEA SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit me numër të prokurimit 622-22-2389-2-2-1, me 10/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE ENG IDEA SH.P.K. me nr. 2023/0904, e datës 13/11/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit me numër të prokurimit 622-22-2389-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim, çështje e gjykuar.**

2. **Urdhërohet** në afat prej 5 ditësh, AK që ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik ENG IDEA SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.03.2022, KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit me numër të prokurimit 622-22-2389-2-2-1. Ndërsa me datën 23.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar procedurën e tenderit sepse nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur, me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 100,000.00 €.

Me 30.10.2023, OE ENG IDEA SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 02.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 13.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE ENG IDEA SH.P.K., me nr. 904/23 lidhur me aktivitetin "Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit me numër të prokurimit 622-22-2389-2-2-1.

Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ENG IDEA SH.P.K., janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi i parë (I) –*“ OE ankues ENG IDEA SH.P.K. e konteston njoftimin e AK-se - propozimin për anulim te aktivitetit te prokurimit konkretisht arsyetimin e eliminim, ku AK Komuna Prizren, ka potencuar se OE ENG IDEA SH.P.K. me rastin e ofertimit – Licenca e Gjeodetit te z. Ilir Gashit, ka qene e skaduar. Kërkesa e AK sa i perket gjeodetit është plotësuar në përputhje të plotë me përshkrimin si me sipër pika d) Një gjeodet te licencuar nga AKK me jo me pak se 1 vite përvojë pune ne profesion pas diplomimit, por është plotësisht i pasaktë konstatimi se ne kemi ofruar gjeodet qe nuk plotëson vitet e përvojës se kërkuar. Ne kemi ofruar 2 inxhinier te gjeodezisë z.Fjoralb Alla dhe z.Ilir Gashi te dy inxhinieret i plotësojnë kushtet me 1 vite përvojë pune pas diplomimin. Me datën 28.09.2023 na keni kërkuar kërkesë për sqarim te tenderit. Po ashtu gjeodeti yne Ilir ashi posedon Licence qe nga 15.02.2017, Licence kjo e para datës se hapje se ofertave. Ne asnjë pjese te dosjes se tenderit nuk eshte e theksuar se Licenca e gjeodetit me afat te paskaduar. Eksperienca e gjeodetit te paraqitur nga ana jone eshte deshmuar ne te gjitha format e po ashtu për periudhën qe duhet te zhvilloj aktivitetin tani me për këtë objekt te kontratës z Ilir Gashi posedon Licencën.”*

Pretendimi i dytë (II) –*“Eleminimi i grupit tone të OE ENG IDEA shpk & ARCH EMPIRE L.L.C. me arsyetimin per ofrimin e cmimeve jonormalisht te uleta ne dy pozicione per te cilat ka aluduar Komisioni i vleresimit eshte i paqendrueshem. Ne pergjigjen tone te dates 03.10.2023 ne kemi dhene pergjigje te detajuar lidhur me çmimet dhe pergjegjesite tona lidhur me realzimin e sherbimeve. Mbetemi te bindur qe ne kete rast e vetmaj rruge ligjore per llogaritjen e çmimeve jonormailisht te uleta eshte tabela per llogaritjen dhe percaktimin e kushteve per te konsideruar cmimet jonormalisht te uleta. Edhe nje here ju rikutojme se pozicionet per te cilat pretendon AK qe i kemi jonormalsiht te uleta jane poz 2 eshte mbi 100% me i larte se dy ofertuesit e tjere ne gare ndersa poz. 3 eshte 20 % me i larte se dy ofertuesit e tjere ne gare. Bashkangjitur gjeni tabelen dhe llogaritjen per cmime jonormalisht te uleta e cila eshte plotesisht ne perputhje me ligjin dhe rregulloren per percaktimin e cmimit jonormalisht te ulete e qe AK nuk e merr fare ne konsiderate. E gjithe kjo per arsye se AK nuk eshte e interesuar te shperbleje me kontrate grupn tone te OE ENG IDEA shpk & ARCH EMPIRE L.L.C. !, sic ka vepruar ne vazhdimisht ne aplikimet e ndermarrjeve tona qofte si konsorcium apo te veteme.”*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE ENG IDEA SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 55, 59, 60, 61 dhe 68 të LPP duke theksuar po ashtu se deri me tani AK me joseriozitetin e saj ndaj kësaj procedure te prokurimit ka nxjerr hiq me pak se 6 vendime për shpërblim me kontrate te OE -ve te ndryshëm te gjithë me shkelje ligjore te cilat janë dëshmuar ne te gjitha vendimet e mëparshme te OSHP-se për këtë procedurë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 21/11/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes

dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 904/23, ndërsa me datë 27/11/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0904 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. "*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues duke theksuar "*dhe pas kërkesës për informacione shtesë lidhur me gjeodetin i cili nuk ishte i caktuar sipas kërkesës sonë por që ishte në listën e OE, Informatat shtesë na kanë bere me dije se ky gjeodet nuk ka qen i licencuar në kohën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe nga kjo arsye OE prap është shpallë i papërgjegjshëm"* ndërsa OE nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE ENG IDEA SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0904 ka vlerësuar si në vijim:

Pergjigje në pretendimin e parë - Eksperti shqyrtues, sqaron se për këte qeshtje, AK- Komuna Prizren, tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ka kërkuar: "Një gjeodet te licencuar nga AKK me jo me pak se një vit me përvojë pune ne profesion pas diplomimit". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Diplome, Licence e lëshuar nga AKK, dëshmi mbi përvojën e punës". Operatori Ekonomik ankues ne oferte ka prezantuar me staf kualifikues ku ne mesin e tyre sipas listës ka ofertuar me dy gjeodet për kudër kesaje lidhur me gjeodetin e kontestuar z. Gashi, rezultoi qe i njëjti është gjeodet i licencuar nga Agjencia Kadastrale i Kosovës, ku një gjë e tille konfirmohet sipas listës te gjeodetve te publikuar ne ueb faqen e AKK-se, përveç kësaj z.Gashi rezulton te jete edhe ekspert gjyqësor sipas listës se Këshillit Gjygjesor te Kosovës nga

lemia e gjeodezise. Rrjedhimisht licenca ne AKK ripërtërihet dhe vazhdohet prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues për këtë pike te eliminimit pretendimin e ankimor e ka te bazuar me qe AK Komuna Prizren tek kërkesa apo dëshmia nuk kane kërkuar qe licenca duhet te jete valide ne momentin e dorëzimit te tenderit.

Pergjigje në pretendimin e dytë - Lidhur me piken e dyte te eliminimit sa i përket pozicioneve te cilat AK -Komuna Prizren, konsideron se janë si jo normalisht te ulëta eksperti shqyrtues sqaron se AK, për gjate rivlerësim te ofertave ka kërkuar sqarim nga Operatori Ekonomik, ankues për te njëjtat pozicione, ku OE i ka dhëne sqarimet dhe është zotuar se projektit do te realizohet, ku për ketë qeshtje edhe OSHP – Paneli shqyrtues përmes vendimeve paraprake për ketë proceduare te prokurimit për te njëjtin pretendim paneli shqyrtues e ka trajtuar, si pretendim te bazuar dhe AK -ne e ka obliguar qe te beje rivlerësim te ofertave me gjithë atë eksperti shqyrtues vlerësim se rivlerësimi i ofertave nuk është bere ne harmoni me konstatimet dhe me gjetjet paraprake te vendimeve te OSHP-se konkretisht sa i përket ofertës apo pozicioneve te cilave AK konsideron se janë çmime jo normalisht te ulëta, nuk i kane ndjekur rrugët ligjore sipas dispozitave ligjore te nenit 61 te LPP-se, konkretisht nenit 41 paragrafi 2 te Rregullores nr. 001/2022, ku përcakton:

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme :

i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;

ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Përveç asaj qe u përshkrua me larte AK – Komuna Prizren ne dosje te tenderit ka aplikuar masat e sigurimit te ekzekutimit te kontratës, prandaj eksperti shqyrtues edhe ketë pretendim ankimore e kualifikon si te bazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "ENG IDEA SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "ENG IDEA SH.P.K., janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të obliguar AK që aktivitetin e prokurimit Hartimi i projektit për kolektorët kryesorë të Qytetit të Prizrenit me numër të prokurimit 622-22-2389-2-2-1, të kthej në Rivlerësim, pasi që konsiderohet se AK nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe kërkesave te dosjes se tenderit. Paneli Shqyrtues ka konstatuar se rivlerësimi i ofertave nuk është berë në harmoni me konstatimet dhe me gjetjet paraprake të vendimeve të OSHP-se konkretisht çmime jo normalisht te ulëta, si dhe nuk është vepruar konform dispozitave ligjore. Vlen të potencohet se për këtë aktivitet të prokurimit është ankesa e tetë (8) me radhë që është duke u shqyrtuar në OSHP duke filluar nga viti 2022 (vendimet nr. 422/22; 427/22; 30/23; 100/23; 112/23; 504/23; 527/23; 904/23) dhe kjo ka ndodhë për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të AK të evidentuara nga ekspertët shqyrtues por edhe nga panelet shqyrtuese, ku në vendimin 527/23, AK është obliguar që "*AK gjatë fazës së rivlerësimit para se të kërkoj sqarime për OE për çmime jo normalisht të ulët, të bëjë vetë një hulumtim të tregut duke u bazuar në prova dhe fakte të argumentuara dhe konform nenit 59 të LPP të bëjë vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e të gjitha ofertave të përgjegjshme qoftë duke i krahasuar edhe kontratat paraprake të natyrave të njëjta ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore të bëhet hulumtimi në përcaktimin e vlerës së parashikuar të një aktiviteti të prokurimit dhe pastaj në kohën kur të ofrohen sqarimet e ofruara nga palët të jepet arsyetim i detajuar rreth aprovimit/mos aprovimit të sqarimeve. Paneli e ka parasysh se kur kemi të bëjmë me kontrata për shërbime është shumë e vështirë të bëhet vlerësimi i pozicioneve por AK duhet të jetë i kujdesëshëm dhe të respektoj të gjitha dispozitat ligjore që është i obligueshëm ti respektoj. Sepse i gjithë ky prolongim dhe vonesë që ka ndodh në këtë aktivitet të prokurimit dhe të disatën herë të trajtuar nga OSHP dhe ekspertët e saj kanë konstatuar se për shkak të mos respektimit në tërësi të dispozitave ligjore nga ana e AK*". Kështu që, paneli shqyrtues vjen në konstatim se AK nuk ka respektuar në tërësi vendimin në fjalë, ngase askund nuk është gjetur se AK ka bërë një hulumtim rreth këtyre çmimeve që janë paraqitur si jo-normalisht të ulëta, po ashtu edhe sa i përket pohimet tjetër ankimore paneli shqyrtues verifikon se është çështje e gjykuar me vendimin paraprak të OSHP Nr. 112/23, me çrast AK nuk iu është përmbajtur. Andaj, këto pohime ankimore paneli shqyrtues nuk ka si mos ti trajtoj ndryshe përveç çështje e gjykuar, konform nenit 105, paragrafi 2.16 të LPP, citat: "Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata".

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues Komuna Prizren. që në tërësi të zbatohen vendimet e OSHP. OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) - Komuna Prizren. që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) - Ndërmarrja Publike Banesore SH.A. në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën ankimore është vendosur konform nenit 31 paragrafi 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **ENG IDEA SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: